REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN**

**PËR**

**"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"**

**Konsultim publik** : Lagjia nr.4.

**Data** : *25.09.2026* **Ora** : *13.00* **Vendi:** *Salla e Këshillit Bashkiak.*

**Numri i pjesëmarrësve** : *Numri i pjesmarrësve 23, nga të cilat 2 gra.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : *Për draft-projekt planin buxhetor afatmesem 2027-2029 të Bashkisë Shkodër.*

**Pjesëmarrës :** Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi drejtohet nga Zv.Kryetari i Bashkisë Z.Bekim Mema,i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

## I. Paraqitja e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe projektbuxhetit

Takimi u hap nga **Zv.Kryetari i Bashkisë Z.Bekim Mema,** i cili ftoi banorët të paraqisnin problematikat dhe propozimet e tyre dhe të përcaktonin prioritetet që, sipas nevojave të komunitetit, duhet të merren në konsideratë gjatë planifikimit të buxhetit të vitit 2027 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029.

Pjesëmarrësit u ftuan të fokusoheshin në nevojat që lidhen me funksionet dhe shërbimet e Bashkisë Shkodër, përfshirë infrastrukturën rrugore, ujësjellës-kanalizimet, ndriçimin publik, pastrimin dhe menaxhimin e mbetjeve, hapësirat publike, transportin, arsimin dhe nevoja të tjera të komunitetit.

## II. Diskutimet, kërkesat dhe propozimet

**Banor i lagjes Ajasëm:** Kërkoi ndërhyrje në rrugën e dëmtuar nga punimet pranë xhamisë, përfundimin e lidhjes me rrjetin e ujësjellësit, ndërtimin e kanalizimeve të ujërave të zeza për shkak të numrit të madh të gropave septike, shtimin e ndriçimit në rrugica dhe zgjidhjen e bllokimit të ujërave të bardha. Kërkoi gjithashtu vendosjen e parmakëve në Urën e Qafës, vëmendje për Ura e Veve dhe verifikimin e një bume të dëmtuar në zonë.

**Banor i lagjes Tepe:** Rikujtoi kërkesat e mëparshme për ujësjellësin dhe kanalizimet, duke theksuar se gjatë verës zona kishte mungesë uji të pijshëm, pavarësisht afërsisë me rezervuarin.

**Z. Xhevat Ibrahimi, banor i lagjes Perash:** Kërkoi përfshirjen e pallateve të zonës në investimet për veshjen e fasadave, plotësimin e ndriçimit publik dhe masa për problematikën e qenve endacakë.

**Z. Besim Rama, banor i lagjes Tepe:** Ngriti mungesën e shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, pavarësisht faturimit, dhe kërkoi të shqyrtohet eliminimi i faturimit aforfe deri në ofrimin e shërbimit të rregullt.

**Z. Bardhyl Sokoli, banor Qafëhardhi:** Kërkoi masa që tregtarët ambulantë të përdorin tregun e hapur në zonë dhe të mos tregtojnë në rrugë. Ngriti mungesën e kazanëve në disa pika pranë rrugicës Vasije dhe qendrës shëndetësore. Kërkoi verifikimin e një hapësire të përdorur si parkim në sheshin Spahije, ku qëndrojnë automjete të papërdorura, si dhe vijimin e lirimit të trotuareve nga shtesat në rrugën Qafëhardhi.

**Z. Angjelin Markolaj:** Kërkoi riveshjen e një segmenti rreth 50 m në rrugën Babaj, të dëmtuar gjatë ndërhyrjeve në rrugën Besnik Sykja. Ngriti problematikën e parkimit për banorët dhe kërkoi verifikimin e një shtëpie të vjetër që paraqitet si problematikë në zonë.

**Z. Kujtim Zylja, banor i lagjes Perash, rruga Koplikej:** Kërkoi ndërhyrje për prerjen e një peme të madhe pranë dy pallateve të fundit në rrugën Koplikej, për shkak të shqetësimit që krijon për banorët.

**Z. Drini Bushati:** Ngriti problematikën e një grope septike që mbledh ujërat e zeza pranë pallatit të Kinezëve dhe kërkoi zgjerimin e saj ose investim në kanalizime. Kërkoi gjithashtu pastrimin dhe sistemimin e lulishtes së afërt, duke theksuar se ndërhyrja ishte kërkuar edhe më parë.

**Z. Ardit Kraja:** Kërkoi sistemimin e parkimit pas pallatit të Kinezëve dhe përmirësimin e aksesit të automjeteve. Ngriti gjithashtu gjendjen e sheshit kryesor të shatërvanit, i cili sipas tij ka nevojë për sistemim.

**Z. Bardhyl Sokoli:** Kërkoi parashikimin e tualeteve publike në qytet, duke e lidhur këtë nevojë edhe me kërkesat e turistëve.

**Banor i lagjes Perash:** Kërkoi që bumet e vendosura privatisht pranë pallateve të zëvendësohen ose standardizohen nga Bashkia.

**Z. Muhamet Kacirani:** Vlerësoi funksionimin e shërbimeve të pastrimit dhe gjelbërimit në zonë, por kërkoi përfshirjen e një blloku pallatesh që ka mbetur pa veshje fasade. Ngriti gjithashtu rrezikshmërinë e kabujve pranë pallateve.

**Z. Vehbi Ismaili, banor i Tepes:** U shpreh se në zonë po realizohet një investim për kolektorin, por kërkoi zgjidhjen e daljes së ujërave të bardha në kanalin e ri, pasi aktualisht nuk ka dalje funksionale.

## III. Evidentimi i prioriteteve dhe dokumentacioni

1. Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe ndërtimi/rehabilitimi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Ajasëm dhe Tepe.
2. Sistemimi i rrugëve, ujërave të bardha, ndriçimit publik dhe elementeve të sigurisë në Ajasëm, përfshirë urat dhe bumet.
3. Trajtimi i faturimit aforfe në zonat ku shërbimi i ujit nuk ofrohet rregullisht.
4. Shtimi i pikave të grumbullimit të mbetjeve dhe organizimi i tregtimit në hapësirat e përcaktuara, jo në rrugë.
5. Sistemimi i parkimeve dhe lirimi i trotuareve nga pengesat dhe shtesat që kufizojnë lëvizjen.
6. Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës Babaj, rrugës Koplikej dhe zonës së pallatit të Kinezëve.
7. Përmirësimi i hapësirave publike, përfshirë lulishten, sheshin e shatërvanit, fasadat e pallateve dhe tualetet publike.
8. Zgjidhja e problematikave të kabujve të rrezikshëm, qenve endacakë dhe shkarkimit të ujërave të bardha.

Kërkesat, vërejtjet dhe propozimet e mësipërme administrohen si pjesë e dokumentacionit të këshillimit publik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe projektbuxhetin vjetor 2027.

Ato pasqyrojnë ndërhyrjet dhe prioritetet e paraqitura gjatë takimit dhe nuk përbëjnë vendimmarrje të pjesëmarrësve.

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**

Zbardhi proces verbalin :

**Bekim Mema**

**Irma Sulishti**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**LISTË PREZENCË**

**KONSULTIM PUBLIK**: ***" PËR DRAFT PROJEKT PLANIN BUXHETOR AFATMESEM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"***

***Lagjia nr.4*** ***Datë: 25.09.2026***

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Altin Alibeh. | Oaf ē | 067252825 2 | | |
| 2. | Artil Kuka | Oaf e | 0688347006 | | |
| 3. | Arbit Hrajca | Pyrru cē | | | |
| 4. | Jagfun Lleshi | Perash | | | |
| 5. | Driini Bushati | Pornuw | 0672020282 | | |
| 6. | Besnik Peshu | Pornuci | | | |
| 7. | Besnik Lama | Tepe - Vjetra | | | |
| 8. | Besnik Dushi | Tepe - vjetra | | | |
| 9. | Mir Ukiim | Rr. Mbreti Gent | | | |

| NR. | EMRI MBIEMRI | LAGJJA/FSHATI | KONTAKT (tel) | e-mail | FIRMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 10. | Behxhetolin Gjolleshi | TEPC | | | |
| 11. | Muhamet Kegxhaj | Kr. Balonë Bepa | Tel: 068 602 4401 | muhametkegxhaj@hotmail.com | |
| 12. | Bardh Sakoli | Ahmet Gjonduli Kolesh | | | |
| 13 | Armando Likaj | Peqosh | 069 3606 101 | | |
| 14. | Xhevat Haxhiu | Peqaj | 067 357 1590 | | |
| 15. | Ismail Gjonaj | Kuçovë | | | |
| 16. | Viktor Shehu | DPMOP | 0696411334 | | |
| 17. | Elsid Sadiu | NSHPP | 0693810646 | | |
| 18. | Ethem Vuçi | NSHPP | 0676305001 | | |
| 19. | ELEARTI GUCI | BESNIK 21 | 0695121750 | | |
| 20. | Ardjolin Marku | Bulqiz | 0695123612 | | |
| 21. | Stesi Bonici | B. Shkoder | 067 622 6502 | gjonojstesi@gmail.com | |
| 22. | Besjon Cojo | MS. LAGJJA NR 4 | 0698195455 | | |
| 23. | Edmond Shima | Lagjja Nr. 4 | 0694803674 | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |